REPUBLIKA E KOSOVËS : REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

| Pranuar - Primljeno Më/Dana | 30-04-2024 | | |
|---|---|---|---|
| Nr.i organit Org.broj | Numri/Broj | Shtojcë Prilog | Vlera Vrednost |
| 01- | 110/05 | - | 668 |

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Kuvendi i Komunës së Vitisë, në bazë të nenit 12, shkronja d, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), dispozitave të nenit 7 të Ligjit Nr.04/L - 076 për Policinë, dispozitave të nenit 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012, MPB-së, 03/2012 të MAPL-së për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi dhe nenit 36, paragrafi 36.2, shkronja d, neni 40, 41, shkronja a të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më datën 29.04.2024 miraton këtë:

# VENDIM

**për ndryshim plotësim të vendimit Nr.01-110/05-111, të datës 01.02.2022, të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi**

1. Me këtë Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për ndryshim plotësimi i vendimit Nr.01-110/05-111, të datës 01.02.2022, të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi pranë Komunës së Vitisë.

2. Konformë pikes 1 të këtij vendimi, Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi pranë Komunës së Vitisë, anëtari z. Radovan Djuriç, përfaqësues i Komunitetit për Komunitete zëvendësohet me z. Sardjan Djuriç përfaqësues i Komunitetit për Komunitete, ky zëvendësim bëhet sepse z.Radovan Djuriç ka ndërruar jetë ne jemi të detyruar të bëjmë zëvendësimin e tij.

3. Të gjitha pjesët tjera të vendimit Nr.01-110/05-111, të datës 01.02.2022, të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi pranë Komunës së Vitisë mbeten në fuqi.

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës së Vitisë.

5. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8, lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:
1. Shërbimit të Kuvendit;
2. Anëtarëve të KKSB-së; dhe
3. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
KRYESUESI
Bekim Azizi